



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_/\_\_\_/2018

**V E N D I M**

**Nr. 125, Datë 21/05/2018**

Mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe në zbatim të Vendimit nr. 1668, datë 03.05.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 64, datë 14.05.2018, e Shoqatës “Sonce”, me përfaqësues Z. V. S., shtetas shqiptar me kombësi maqedonase, ku pretendohet diskriminim për shkak të etnisë, nga ana e Ministrisë të Punëve të Jashtme, Z. D.B.<sup>1</sup>.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

**K O N S T A T O I:**

Referuar shpjegimeve të dhëna nga subjekti ankues Shoqata “Sonce”, Ministri i Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë, Z. D.B., në një intervistë të dhënë për televizionin Top Channel, në datën 09.01.2017, duke folur për situatën në Maqedoni, popullit maqedonas iu referua me termin “sllavo maqedonas”.

Sipas subjektit ankues, përdorimi i termit “sllavo-maqedonas” është një fyerje e rëndë për popullin maqedonas në mbarë botën, si dhe për komunitetin maqedonas në Republikën e Shqipërisë, i cili është i njohur zyrtarisht nga shteti shqiptar. Për këtë arsye, V. S., kryetar i Shoqatës “Sonce” pretendon se kjo deklaratë, është e papërshtatshme dhe ofenduese.

---

<sup>1</sup> Aktualisht, emërtesa e pozicionit që mban Z. D.B. është Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme.